

E DREJTA PËR INFORMIM

Takim me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, të informuar e ndërgjegjësuar për respektimin e të drejtave të qytetarëve



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mikpritri në një takim njohës e ndërgjegjësues një grup studentësh të Departamentit të Drejtësisë Publike të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.

Qëllimi i tij ishte informimi mbi rolin, funksionet dhe veprimtarinë e një prej tre institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, siç është Zyra e Komisionerit. Në këtë takim, i zhvilluar në formën e bashkëbisedimit të lirë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, paraqiti kuadrin ligjor e rregullator për fushat e përgjegjesisë së institucionit, foli për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, për rritjen e përgjegjshmërisë dhe masave tekniko-organizative për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve, për aspekte e procese konkrete të punës apo dhe për veprimtarinë ndërgjegjësuese për respektimin e këtyre dy të drejtave. Aktiviteti u mbajt si pjesë e projektit “Mjetet dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri” që Fakulteti i Drejtësisë po zhvillon me studentët e tij.

Zyra e Komisionerit i kushton rëndësi ndërveprimit dhe bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në kuadër të veprimtarisë mësimore akademike/didaktike të të rinjve, si një mundësi për zgjerimin e njohurive të tyre dhe përgatitjen e profesionistëve të së ardhmes.



Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 50 - Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Vendim Nr. 51 - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Vendim Nr. 52 - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2023, ka dhënë 3 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me vendimin nr. 51, datë 08.11.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik "Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni (ndër të tjera) për projektin "Jonian Heaven" dhe konkretisht :

- Proces-verbalet e çdo mbledhjeje të KKMTS-së për këtë projekt;
- Të gjitha dokumentet, përfshirë projektin teknik, detajet e tjera teknike, studimet dhe çdo dokument të ngjashëm, të dorëzuar pranë autoritetit publik.

Autoriteti Publik në përgjigjen e tij vlerëson se "Fryma që ndjekë neni 7 i Ligjit Nr. 119/2014, ka të bëjë me publikimin e akteve të miratuara nga ana e autoritetit publik. - Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në nenin 17 të tij, parashikon rastet kur e drejta e informimit kufizohet nëse dëmtohen interesat që lidhen me sekretin tregtar dhe të drejtën e autorit. Në lidhje me pikën 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 119/2014, sqarohet se, aplikuesi dhe zhvilluesi i projektit "Jonian Heaven" është subjekt privat. Në këto kushte, IKTK e ka të pamundur vënien në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjeve mbi projektet e sipërcituara. Për më tepër, procesverbalet e mbledhjeve të KKTKM-së janë të një natyre të diskutimit paraprak midis anëtarëve mbi vendimmarrjen. IKTK bënë publik, nga ana formale, aktin e miratuar në KKTKM, i cili në rastin konkret është Vendimi Nr. 271, datë 08.06.2021. Me qëllim realizimin e të drejtës për informim, sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 119/2014, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm duke parashikuar një klauzol brenda rasteve të kufizimit sipas pikës 1 të nenit 17, ku citohet se "informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij". Pra, ky përfundim nga rregulli i përgjithshëm mbi rastet e kufizimit, zbatohet kur përmbushet kushti i vendosur në ligj që është ekzistenca e interesit publik më të lartë në dhënien e këtij informacioni. Kërkuari nuk ka dhënë argumente bindëse mbi përcaktimin e interesit publik më të lartë, i cili përcaktohet si përfundim në dhënien e informacionit, sipas pikës 1, neni 17 i ligjit të sipërcituar".

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit nuk ka dokumentuar/provuar ekzistencën e këtyre dy të drejtave. Po ashtu Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si e drejta për informim kufizohet kur është e domosdoshme, propocionale si dhe dëmin që mund t'u shkaktojë palëve mbi sekretin tregtar dhe të drejtën e autorit, si pasojë e vendosjes në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", "Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve". Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesat e ankuesit për t'u informuar nuk çenojnë apo zhveshin autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.

Pavarësisht sa më sipër, në çdo rast, Autoriteti Publik duhet të kishte argumentuar moszbatimin e parashikimit në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Duke qene se informacioni i kërkuar paraqet interes për publikun, rrjedhimisht, ky dokumentacion, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Zyra e Komisionerit pjesë e projektit “BE për Qeverisjen e Mirë”

Në mjediset e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një takim pune në kuadër të projektit “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”, me ekspertët e tij, z. Tibor Draskovics dhe z. Zoran Jachev.

Zbatimi i këtij projekti ka nisur me fazën e identifikimit të problematikave apo nevojave të institucioneve shqiptare. Zyra e Komisionerit do të jetë një nga autoritetet kryesore të përfshira në këtë iniciatë, me tre komponente:



- forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit për zbatimin efektiv të ligjit nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” (Konventa 205) dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;
- ofrimin e asistencës për të garantuar zbatimin efektiv të Konventës së modernizuar të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108+);
- mbështetje koordinatorëve për të drejtën e informimit, gjithashtu, institucioneve qendrore dhe vendore, për të përmirësuar trajtimin e kërkesave për informacion për një zbatim më efektiv të ligjit për të drejtën e informimit.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDMDP)